

Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

dhjetor 2015 – prill 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје

Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin (dhjetor 2015 – prill 2016)

Instituti për demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS) nga qershori i vitit 2014 e përcjell cilësinë e debatit në Kuvendin. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015¹. Nga shtatori i vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon i përkrahur nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017.

Monitorimi në këtë periudhë fokusohet në diskutimet që kanë të bëjnë me rendin kuvendor të ditës të cilat bëjnë pjesë në sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Në këtë drejtim monitorohen të gjitha ato trupa kuvendore në fushëveprimin e të cilave bëjnë pjesë këto tema. Në mënyrë shtesë, në kuadër të projektit janë të përfshira edhe mediet, përkatësisht përcillet se si ato raportojnë për punën e Kuvendit.

Gjatë monitorimit gjetjet për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik publikohen në formë të raporteve tremujore. Para jush është raporti i parë tremujor për cilësinë e debatit në Kuvendin i cili ka të bëjë me periudhën nga 1 shtatori deri më 30 nëntor të vitit 2015.

Rezume

Në periudhën 1 dhjetor 2015 – 6 prill i vitit 2016 në mënyrë të butë **u zvogëluar intensiteti i diskutimeve** rreth pikave nga rendi i ditës që kanë të bëjnë me temat nga sundimi i të drejtës, demokracisë, të drejtat e njeriut, transparencën dhe llogaridhënie.

Janë analizuar gjithsej 1542 diskutime të deputetëve të bëra për 51 pikë nga rendi i ditës i seancave kuvendore dhe të trupave punuese. Në periudhën paraprake të monitoruar shtator – nëntor 2015 u analizuan gjithsej 1660 diskutime.

Në seancat e vëzhguara deputetët diskutuan më intensivisht në **katër temat e mëposhtme: "Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2015" 282 diskutime, "Informacioni në lidhje me ndotjen e madhe të ambientit ajër " – 254, "Interpelancë për punën e ministrit të shëndetësisë Nikolla Todorov" - 146 dhe "Propozim vendim për zgjedhjen e presidentit, zëvendësave dhe anëtarëve të Komisioni anketues për aferën me fabrikën për falsifikimin e letërnjoftimeve , pasaportave, aferave dhe dokumenteve tjera" me 119 diskutime.** Ndryshe nga këto tema deputetët veçanërisht nuk ishin të interesuar për të diskutuar emërimin e ministrave të rinj të kabinetit nga BDI. Në këtë temë janë vërejtur vetëm 17 diskutime.

Pjesa më e madhe e diskutimeve – 77% shkojnë në replika dhe kundër-replika, ndërsa 20% në fjalime që vë në pah interaksionin intensiv midis deputetëve të blloqeve të ndryshme politike.

¹ Cikli i parë i cilësisë së debatit dhe të raportimit mediatik u zhvillua në kuadër të projektit "Kuvendi nën thjerrëz. Përforsimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ" i financuar nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe i bashkë-financuar nga IDSCS dhe IEKOB. Raportin e plotë për cilësinë e debatit në ciklin e parë të vëzhguar i cili e përfshiu periudhën nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 është i qasshëm në linkun vijues: <http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/rovovska-debata-mk.pdf>

Sipas shkallës së argumentimit më të shpeshta janë diskutimet me nga një argument – 29% dhe ato në të cilat deputetët nuk dhanë kurrfarë arsytimi rreth temave të diskutimit - 29%. Mandej vijojnë diskutime me arsytim të dobët – 27% në të cilat ekziston ndonjë farë arsytimi, por nuk është dalluar një argument i plotë.

Pjesa më e madhe e diskutimeve në seancat e monitoruara janë shprehur nga deputetët opozitarë - 55%, ndërsa pjesa më e vogël nga deputetët e shumicës në pushtet – 45%.

Njëlloj si edhe në ciklin paraprak të monitorimit edhe në periudhën dhjetor 2015 – prill 2016 **deputetët mbetën të mbyllur për argumentet e huaja dhe për mundësi të ndryshimit të pozicionit të vet.** Nuk është vërejtur rast i deputetit i cili shfaq se do ta ndryshojë pozicionin e vet për shkak të argumenteve nga opsioni tjetër politik.

Në këtë periudhë të monitoruar **deputetët në përgjithësi ishin të orientuar drejt diskutimit me kundërshtarët e vet politik në kuvendin dhe pothuajse nuk ju bënë vështrim bashkë-partiakëve të vet.** Me këtë rast, ndaj argumenteve dhe personalitetit të kundërshtarëve të vet në pjesën më të madhe nuk kishin gjykime vlerësuese, ndërsa në pjesë më të vogël shfaqën respektim.

Deputetët kur përgjigjeshin në argumentet të cilat u janë drejtuar folësve të tjerë **më shpesh pjesërisht ose në tërësi i shtrembëronin ose injoronin se sa që përgjigjeshin në mënyrë të drejtpërdrejtë në ato.** Në këtë periudhë është vërejtur se deputetët vetëm në 16% të rasteve drejtpërdrejtë janë përgjigjur në argumentet e që u janë drejtuar atyre nga deputetë të tjerë.

Deputetët opozitar më shpesh janë përgjigjur drejtpërdrejtë argumenteve të drejtuara 60%, ndërsa në deputetët nga shumica shkon pjesa më e madhe e rasteve kur diskutuesit tërësisht i injoronin argumentet – 59% ose kur i shtrembëronin argumentet që u janë drejtuar atyre – 67%. Në opozitarët shkojnë një pjesë më e madhe e rasteve në të cilat deputetët në argumentet e drejtuara përgjigjen pjesërisht, ndërsa pjesërisht i shtrembërojnë ose injorojnë – 53%.

Në raportin ndaj argumenteve të kundërshtarëve të tyre në Kuvendin deputetët në pjesën më të madhe të rasteve – 80% nuk shfaqën kurrfarë gjykimi vlerësues.

Ndaj personalitetit të deputetëve nga opsionet e kundërshtuara politike deputetët në **44 raste shfaqën mos-respektim të plotë** që do të thotë se kanë drejtuar sulme dhe fyerje ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë ose ndaj partisë së tyre. Këto raste në mënyrë të njëjtë shkojnë në deputetët edhe nga shumica edhe nga opozita.

Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO – DPMNE) fitoi 61 deputet ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e themeluan Qeverinë, Bashkimi Demokratik për integrim (BDI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë e Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i cili mandatin e vet e fitoi nga RDK edhe krahas vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin iu bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Me atë, tani grupi i deputetëve i BDI-së numëron 20 deputetë. Më 8 maj partia Përtëritja demokratike për Maqedoninë (DOM) e cila ka një deputet (Liljana Popovska) në Kuvendin, vendosi ta braktis koalicionin pushtet-mbajtës. Në periudhën nga 20 qershor i vitit 2014 deri në fund të gushtit të vitit 2015, deputetët e koalicionit më

të madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotoi punën e Kuvendit. Nga 1 shtatori i vitit 2015 deputetët e koalicionit të LSDM u kthyen në parlamentin dhe morën pjesë në punën e tij.

Partitë më të mëdha nga pushteti dhe opozita pas periudhës së vrullshme të krijuar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në prill të vitit 2014 në të cilën u publikuan një varg skandalesh të ndërlidhura me përgjimin e paligjshëm dhe në të cilën ndodhën protesta, më 2 qershor me ndërmjetësim të komisionarit për zgjerim të UE Johanes Han arritën marrëveshje² për tejkalimin e krizës. Marrëveshja përmban një varg masash me afate konkrete të cilat duhet të ndihmojnë që të tejkalohet kriza politike e cila u zhvillua pas shpalljes së bisedave të përgjuara. Masat kanë të bëjnë me kthyerjen e opozitës në Kuvendin, organizimin e zgjedhjeve të reja parlamentare, dorëheqje të qeverisë aktuale, formimin e qeverisë në të cilën në resorë kyç do të emërtohen ministra nga opozita, reforma në legjislativin zgjedhor, themelimin e prokurorisë speciale publike me mandat që ti hetojë theksimet në incizimet e shpallura.

Ndërkohë, ekipi i ekspertëve i angazhuar nga Komisioni evropian i udhëhequr nga Rajnhard Pribe, drejtor i mëparshëm i Drejtorisë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian përgatiti raport të detajuar për problemet në më tepër sfera. Raporti i bën vështrim sistemit gjyqësor, kontrollit të punës së shërbimeve të sigurisë, problemeve gjatë organizimit të zgjedhjeve, gjendjes në mediet dhe udhëzime për reforma në të gjitha këto fusha e qëllimi i kësaj është përmirësimi i gjendjes në të gjitha fushat. Raporti i është dërguar Kuvendit dhe shërben si udhërrëfyes për zbatimin e reformave në sferat e theksuara.

Nga 1 shtatori opozita u kthye në Kuvendin dhe tani ai punon në përbërje të plotë. Në periudhën e monitoruar shtator – nëntor të vitit 2015 shumica në pushtet numëron 81 deputet, ndërsa opozita 42 deputet.

Në tetor të vitit 2015, në pajtim me marrëveshjen, opozita morri poste ministrore në qeverinë e Gruevskit në ministrinë e punëve të brendshme dhe për punë e politikë sociale. Zëvendës ministra opozitar janë emëruar në ministrinë e financave dhe të bujqësisë për ta kontrolluar punën e institucioneve kyçe shtetërore në periudhën e zbatimit të zgjedhjeve. Nga 14 janari i vitit 2016 në krye të Qeverisë është ashtuquajturit kryeministër “teknik” Emill Dimitriev, në vend të liderit të VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski.

Partitë me disa zvarritje në negociatat të cilat zhvillohen midis grupeve të tyre të punës në Klubin e deputetëve me ndërmjetësim të lehtësuesit Peter Vanhoute i angazhuar nga UE dhe SHBA, i shkelën afatet të kontraktuara paraprakisht për zbatimin e reformave. Negociatat për lëmenjtë jurisprudencë dhe medie u ndërpre në mos u arritur marrëveshje. Për shkak të një vargu të mospajtimeve në procesin politik, më 6 prill, ministrat dhe zëvendës ministrat plotësues të LSDM parashtuan dorëheqje nga funksionet e tyre në Qeverinë të cilat të cilat formalisht nuk u shqyrtuan dhe pranuan nga Kuvendi. Më 8 prill, Qeveria e Emil Dimitriev pa praninë e funksionarëve nga LSDM, i suspendoi vendimet e tyre të deri atëherëshme.

Më 24 shkurt të vitit 2016 Kuvendi votoi shtyrje të zgjedhjeve për 5 qershor për shkak të mos përmbushjes së një pjese të kushteve të parapara me “Marrëveshjen e Përzhinos”. Më 6 prill shumica pushtetmbajtëse në Kuvendin votoi shpërbërje me çka filloi të rrjedh afati për organizimin e zgjedhjeve të cilat duhet të mbahet më 5 qershor. Koalicioni opozitar i udhëhequr nga LSDM me

² Marrëveshja në opinionin e fitoi emrin “Marrëveshja e Përzhinos” sipas lagjes në Shkup në të cilën është e vendosur rezidenca e UE në të cilën u zhvilluan negociatat politike midis liderëve të katër partive më të mëdha politike në Maqedoni, VMRO – DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH.

arsyetimin se ende nuk janë përmbushur kushtet për organizim të zgjedhjeve fer dhe demokratike paralajmëruan se nuk do të merr pjesë në zgjedhjet. Kriza politike u thellua në mënyrë shtesë pas shpalljes së abonimit (faljes) nga presidenti i shtetit Gjorgje Ivanov më 12 prill të vitit 2016. Ivanov me një fjalim drejtuar popullatës, me arsyetim se dëshiron ta qetësojë krizën shpalli se ka nënshkruar vendime për falje të 56 personave midis të cilave edhe liderët e partive më të mëdha Nikolla Gruevski të VMRO-DPMNE-së dhe Zoran Zaev të LSDM. Falja nga Ivanovi shkaktoi protesta masive të qytetarëve dhe të opozitës në Shkup dhe më tepër qytete në shtetin në të cilat kërkohet dorëheqja e tij dhe tërheqja e vendimit me qëllim që të gjitha rastet të cilat i ngrenë PSP të mund të procesohen në mënyrë përkatëse.


Periudha e tërësishme e monitorimit e mbuluar me këtë raport tremujor (dhjetor 2015 – prill 2016) kaloi në shenjën e polarizimit të fuqishëm politik midis dy partive më të mëdha VMRO-DPMNE dhe LSDM, si pasojë e rezultatit të pasuksesshëm të negociatave për dalje nga kriza politike.

Gjetje nga monitorimi

Lloji i diskutimeve

Në Kuvendin në periudhën nga 1 dhjetori i vitit 2015 deri 6 prill të vitit 2016 u zvogëluar intensiteti i diskutimeve që kanë të bëjnë me temat sundimi i të drejtës, demokracisë, të drejtat e njeriut, sundim transparent dhe llogaridhënës. Në këtë periudhë janë analizuar gjithsej 1542 diskutime të deputetëve për pika nga rendi i ditës të Kuvendit të cilat hynë në sferat e theksuara. Për krahasim, në periudhën paraprakisht të monitoruar, nga shtatori deri në nëntor të vitit 2015, u analizuan gjithsej 1660 diskutime në sferat e njëjta. Diskutimet në periudhën dhjetor 2015 – prill 2016 janë të bëra në kuadër të 51 pike të rendit të ditës në seancat plenare dhe seancat e trupave punuese³.

Sipas përkatësisë politike të diskutuesve, 55% nga diskutimet u takojnë deputetëve të opozitës, ndërsa 45% deputetëve që janë pjesë e shumicës pushtetmbajtëse.




Sipas llojit, pjesa më e madhe e diskutimeve shkojnë në replika (39%) dhe kundër- replika (38%), përkatësisht madje 77% nga diskutimet e analizuar i kanë takuar njërit nga këto dy lloje.⁴ Vetëm 20% nga diskutimet shkojnë në fjalime. Ky raport sipas llojit të diskutimeve është i ngjashëm njëlloj si

³Komisioni për financim dhe buxhet, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisioni anketues për skandalin me përgjimet, Komisioni për mbikëqyrje të masës së posaçme hetimore përcjellje të komunikimeve nga Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria për polici financiare, Drejtoria e doganave dhe Ministria e mbrojtjes si dhe Agjencia për zbulim.

⁴ Në sajë të Rregullores së punës së Kuvendit fjalimet në seancat kuvendore janë kufizuar në 10 minuta. Replikat zgjasin 3 minuta, ndërsa kundër-replikat 1 minutë. Përgjithësisht nga kjo rregull janë seancat në të cilat debatohet për Buxhetin në Komisionin për financa dhe buxhet në të cilat anëtarët e trupit punues gjatë debatit të përgjithshëm mund të flasin vetëm dy herë në kohëzgjatje prej gjithsej 20 minuta, ndërsa koordinatori i grupit të deputetëve gjithsej 30 minuta.

raporti në kuartalin e parë të monitorimit (shtator-nëntor 2015) kur në fjalime shkuan 19% nga diskutimet, ndërsa në replikat dhe kundër-replikat bashkë 75% nga diskutimet.

Për krahasim, në ciklin e parë të monitorimit të cilësisë së debatit në Kuvendin të zbatuar nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 kur opozita mungonte në Kuvendin në të gjitha temat nga rendi i ditës kuvendor u analizuan gjithsej 2271 diskutim nga të cilat 72% ishin fjalime, 14% replika dhe 14% kundër-replika.





Nëse analizohet sipas përkatësisë politike të folësve, në periudhën dhjetor 2015 – prill 2016 pjesa më e madhe e fjalimeve shkojnë në deputetët opozitar – 68%. Replika më shpesh kanë deputetët nga pushteti – 68% , ndërsa pjesa më e madhe e kundër-replikave janë shfaqur nga opozitarët – 73%.

Shkallë e argumentimit


Deputetët në diskutimet kuvendore në periudhën nga dhjetori i vitit 2015 deri në prill të vitit 2016 pozicionet dhe qëndrimet e veta i përfaqësonin dhe arsyetonin me shpesh me një argument – në 29% nga rastet. Në 27% të rasteve nuk është vërejtur asnjë argument i plotë përkatësisht arsyetimi ka qenë i dobët. Në 29% të diskutimeve deputetët aspak nuk kanë dhënë kurrfarë arsyetimi rreth temave të diskutimit. Në këtë përqindje janë përfshirë edhe diskutimet në të cilat deputetët vetëm pyesin, kërkojnë ose japin sqarim të shkurtër deri në fund të diskutimeve paraprake, por edhe rastet kur ata mes vete sulmohen rreth tema të tjera jashtë nga ajo e cila është në rend dite, për politika dhe raste nga e kaluara, ose për çështje aktuale që nuk janë të ndërlidhura me temën e diskutimit. Diskutimet në të cilat deputetët japin arsyetim më të gjerë dhe mbështetje të pozicioneve të veta me më tepër argumente edhe në këtë periudhë, njëlloj si në atë paraprake, janë pakicë. Në të vërtetë folësit në parlamentin kanë përdorur dy argumente në 9%, ndërsa më tepër se dy vetëm në 5% të diskutimeve.

Ky raport është i ngjashëm me cilësinë e diskutimeve në periudhën e monitoruar paraprake shtator – nëntor 2015. Atëherë dy dhe më tepër argumente ishin të vendosur në 5% të diskutimeve. Me dy argumente ishin 9% , me një 30% , ndërsa në 23% të diskutimeve arsyetimi ka qenë i dobët. Pa kurrfarë diskutimi ishin 31% të diskutimeve të monitoruara.



Nëse analizohet sipas përkatësisë politike të folësve në periudhën dhjetor 2015 - prill 2016 rezulton se pjesa dominante e diskutimeve në të cilat janë identifikuar dy dhe më tepër argumente u takojnë deputetëve opozitar. Në deputetët nga opozita gjithashtu shkojnë 66% të diskutimeve në të cilat janë identifikuar dy argumente, 52 % të diskutimeve me një argument, por edhe 54% prej atyre janë me arsyetim të dobët dhe 52% të diskutimeve pa arsyetim.

Në raport me atë se si ju përgjigjen deputetët pyetjeve të drejtuara ose argumenteve ndaj tyre nga folësit e tjerë rezulton se shpesh nuk përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në thelbin e argumenteve të drejtuara. Në këtë periudhë në 16% të diskutimeve deputetët u përgjigjën në mënyrë përkatëse argumenteve ose pyetjeve të cilat u ishin drejtuar atyre. Në 10% tërësisht i shtrembëruan, ndërsa në 15% të rasteve tërësisht i injoruan argumentet ose pyetjet e drejtuara për ta nga folës të tjerë. Në 65% të rasteve diskutuesve aspak nuk u janë drejtuar argumente ose pyetje nga diskutuesit e tjerë.




Nëse kjo kategori analizohet përmes përkatësisë politike të folësve rezulton se në diskutimet e monitoruara opozitarët diç më shpesh përgjigjeshin drejtpërdrejtë në argumentet e drejtuara ndaj tyre nga folësit tjerë - 60% krahasuar me deputetë nga shumica – 40%. Në dy opsionet politike shkon pothuajse përqindja identike e diskutimeve në të cilat deputetët vetëm pjesërisht u përgjigjën në mënyrë përkatëse në argumentet e drejtuara, ndërsa pjesërisht i shtrembëronin ose injoronin ato argumente - 53% të këtyre rasteve të deputetëve opozitar, ndërsa 47% të deputetëve nga shumica në pushtet. Pjesa më e madhe e diskutimeve në të cilat deputetët tërësisht i shtrembërojnë argumentet ju takojnë folësve nga shumica – 67% , ndërsa pjesa më e madhe opozitarëve – 33%. Gjithashtu, deputetëve nga shumica shkon pjesa më e madhe e diskutimeve në të cilat tërësisht injorohen argumentet të cilat ja ka drejtuar deputet tjetër – 59% .

Në seancat e vëzhguara, diskutimet e deputetëve kanë zgjatur rreth 3 minuta. Në qoftë se koha totale e diskutimit ndahet në bazë të përkatësisë politike të folësit vijmë në rezultat se çdo deputet i opozitës ka folur mesatarisht 3.5 minuta, dhe secili nga shumica parlamentare nga 2 minuta.

Fuqia e argumentit më të mirë dhe në emër të kujt paraqiten argumentet

Sërish njëlloj si në të gjitha periudhat e deritanishme të monitorimit të cilësisë së debatit parlamentar te deputetët mbetet mos ndryshimi konstant të qëndrimeve dhe pozicioneve gjatë diskutimeve. Ndryshimi i pozicionit është përjashtim i rrallë që vë në pah pozita të ngurta fillestare të deputetëve para se të hynë në sallat parlamentare dhe fleksibilitet dhe mbyllje ndaj qëndrimeve të folësve të tjerë. Kjo pasqyrohet në faktin që edhe në këtë periudhë të monitoruar nuk është vërejtur asnjë rast kur folësi ka vënë në pah se e ndryshon pozicionin e vet për shkak të argumenteve më të mira të shfaqura nga folësit e tjerë. Gjithashtu nuk është vërejtur asnjë rast i vetëm në të cilin folësi ka vënë në pah se e ndryshon pozicionin e vet për shkak të tjera.


Deputetët në këtë periudhë të seancave të monitoruara në më shumë se gjysmën e rasteve – 59% nuk e n jeh vlefshmërinë e argumenteve të kundërshtarëve të vet. Qëndrim të tillë kanë marrë në mënyrë të njëjtë edhe deputetët nga shumica edhe nga opozita gjë e cila e pasqyron greminën e fuqishme midis subjekteve politike në parlamentin. Në 37% të rasteve folësit aspak nuk i kanë vështruar argumentet e huaja, ndërsa vetëm në 2% përkatësisht në 22 diskutime folësit kanë shprehur një farë pranimi të vlefshmërisë së argumenteve të kundërshtarëve të vet, por prapëseprapë kanë mbetur në pozicionet e veta.



Në periudhën e monitoruar në pothuajse gjysmën e diskutimeve – 49% i ndërlidhin argumentet e prezantuara me të mirën e përgjithshme të të gjithë qytetarëve dhe të shoqërisë. Në 28% të rasteve është vërejtur se folësit kanë qenë neutral përkatësisht nuk i ndërlidhën argumentet e veta me


përfitime ose pasoja prej tyre për të gjithë qytetarët ose për grupe të caktuara. Në 6% të rasteve folësit e ndërlidhën argumentet e veta me përfitime ose pasoja për grupe të tjera. Nën nocionin grupe të tjera nënkuptohen grup politik, etnik, religjioz, profesional ose social me të cilin deputeti nuk identifikohet, por ndaj të cilit bën vështrim në diskutimin e vet dhe në emër të të cilit i orienton argumentet e veta. Në 8% të diskutimeve folësit i kanë ndërlidhur argumentet e veta me grupin e vet. Në 8% deputetët i kanë ndërlidhur argumentet e veta me parime abstrakte si paqe, mirëqenie, drejtësi sociale e kështu me radhë.

Deputetët nga opozita diç më shpesh i ndërlidhin argumentet e veta me të mirën e përgjithshme të të gjithë qytetarëve, por edhe me parime abstrakte krahasuar me deputetët nga shumica.




Respekt, ndërprerje, kufizime dhe gesticulime


Deputetët në periudhën dhjetor 2015 – prill 2016 ngjashëm si edhe në periudhën e monitoruar shtator – nëntor 2015 nuk shprehnin gjykime vlerësuese drejt argumenteve dhe ndaj folësve nga opsioni i ndryshëm politik. Folësit vetëm në 11% të rasteve shprehën respekt ndaj argumenteve të kundërshtarëve të vet, ndërsa në 4% respekt të pjesshëm. Si respekt i pjesshëm shënohen diskutimet në të cilat në pjesën më të madhe folësi ka shfaqur respektim ndaj argumenteve, por në pjesë më të vogël shpreh edhe sulme ose fyerje ndaj argumenteve të folësve nga opsioni tjetër politik në Kuvendin. Në 1% të rasteve është vërejtur se folësit mos-respektim të pjesshëm, përkatësisht në pjesën më të madhe të diskutimeve të veta shfaqën sulme dhe fyerje, ndërsa në pjesën më të vogël respektim ose ishin neutral ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Mos-respektim të plotë ndaj argumenteve të huaja është vërejtur në 1% të diskutimeve nga diskutimet përkatësisht në 10 raste. Me këtë rast, nëse analizohet sipas përkatësisë politike të folësve rezulton se deputetët nga opozita më shpesh aspak nuk u bënë vështrim argumenteve të kundërshtarëve, ndërsa deputetëve nga shumica shkojnë më tepër raste në të cilat është shënuar respektim të pjesshëm, mos-respektim të pjesshëm dhe mos-respektim të plotë ndaj argumenteve të deputetëve të tjerë.



Në pikëpamje të raportit ndaj personaliteteve të deputetëve nga opsionet e kundërshtuara politike është vërejtur se në 52% aspak nuk është shprehur ndonjë farë gjykimi vlerësues. “Respektimi i pjesëshëm” do të thotë se folësit në pjesë më të madhe të diskutimeve të veta kanë shfaqur respekt ose kanë qenë neutral, ndërsa në pjesë më të vogël shfaqën mos-respektim të pjesëshëm. Në 6% të rasteve folësit kanë shfaqur mos-respektim të pjesëshëm, ndërsa në 4% përkatësisht në 44 raste mos-respektim të plotë ndaj deputetëve të opsionit të kundërt politik në Kuvendin. Me mos-respektim shënohen diskutimet në të cilat folësit shfaqin sulme dhe fyerje ndaj personalitetit të folësve të tjerë ose ndaj opsionit të tyre politik.



Përkundër diskutimeve intensive midis deputetëve në periudhën dhjetor 2015 – prill 2016 numri i ndërprerjeve është relativisht i vogël. Vetëm në 6 raste janë vërejtur ndërprerje të cilat kanë zgjatur më pak se 10 sekonda. Këtu janë përfshirë të gjitha ndërprerjet e shkaktuara më shpesh me ndërhyrje të deputetëve të tjerë në diskutimin e folësit me bërtitje ose komentim nga vendi, por pas ndërprerjes e ka vazhduar fjalën e vet. Në 44 raste vënë në pah se nuk është në mundësi të diskutojnë për shkak të kufizimeve nga deputetët e tjerë në sallën që më shpesh përbëhej nga zhurma, bërtitje dhe mos pasje të vëmendjes nga pjesëmarrësit e tjerë në seancën. Nuk është vërejtur rast i kufizimit fizik të diskutimit të ndonjë folësi.



Në pikëpamje të komunikimit jo-verbal në periudhën e monitoruar dhjetor 2015 – prill 2016 është vërejtur se folësi gjestikulon në 80% të rasteve dhe atë në drejtim të plotësisimit dhe theksimit të pjesëve të diskutimeve të veta. Kjo më shpesh ka të bëjë me prezantimin e dokumenteve të ndryshme të cilat diskutuesit ua prezantojnë pjesëmarrësve të tjerë dhe opinionit si plotësim të diskutimeve. Në 1% të rasteve është shënuar se folësit gjestikulojnë ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancën, por nuk është vërejtur rast në të cilin bëhet fjalë për gjestikulim fytes ose sulmues. Në 11% të rasteve nuk është shënuar se folësit përkundër shprehjes verbale kanë përdorur edhe komunikim jo-verbal.

Demografia e folësve, propozues i aktit dhe procedura në të cilën shqyrtohet ligji

Struktura demografike e diskutuesve, diskutimet e të cilëve janë analizuar në periudhën dhjetor 2015 – prill 2016 është me sa vijon:

Gjinia: burra 63%, gra 37%

Përkatësia etnike: Maqedonas 91%, Shqiptarë 7%, të tjerë 2%;

Opsioni politik: pushtet 45%, opozita 55%

Shkallë e arsimit: me arsim të lartë 69%, me studime pas-diplomike (magjistratura dhe doktoratura) 31% .

Njësia zgjedhore: NjZ 1 - 20% , NjZ 2 - 12%, NjZ 3 - 20%, NjZ 4 - 20%, NjZ 5 - 22%, NjZ 6 - 6% dhe NjZ 8 - 1%.

Në periudhën e monitoruar diskutimet e deputetëve janë të shprehura në seancat në të cilat pikat e rendit të ditës ishin:

Lloj i aktit: propozim-ligje 10%, ndryshime dhe plotësime të ligjit 16%, pyetje deputetësh 2% dhe akte të tjera 72%;

Propozues: deputetë 56%, Qeveria 21% dhe qytetarë 23%;

Procedurë në të cilën shqyrtohet: Në procedurë të rregullt 91%, të shkurtuar 9%.

Metodologjia e hulumtimit

Cilësia e diskutimit në Kuvendin analizohet me përdorimin e “Indeksit të cilësisë së debatit”. Indeksi është instrument i cili mundëson që çdo akt i veçantë i fjalimit në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

Shkallë e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në çdo diskutim);

Shkallë e respektimit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;

Transparencë për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimi i qëndrimeve të veta për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debatin;

Nëse deputetët i arsyetojnë qëndrimet në emër të interesave të kujt i përfaqësojnë qëndrimet e veta;

Vallë a mund deputetët në mënyrë të papenguar ti shfaqin qëndrimet e veta.

Me monitorimin janë përfshirë debatet të cilat kanë të bëjnë me pika të rendit të ditës të ndërlidhura me temat: sundimi i të drejtës, të drejtat dhe liritë e njeriut, integritet evropiane, financat publike dhe të tjera për të cilat do të konstatohet se janë në interes për hulumtimin. Në atë drejtim përcillen seancat plenare të Kuvendit dhe të trupave punuese vijuese:

Komisioni për financim dhe buxhet;

Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;

Komisioni për zgjedhje dhe emërimet;

Komisioni për vetëqeverisje lokale;

Komisioni për çështje evropiane;

Komisioni anketues për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarit;

Komisioni ligdhënës – juridik;

Trupe të tjera punuese.

Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencia zvicerane për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim të asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit.

Monitorimi i debatit kuvendor dhe i raportimit mediatik filloi në shtator të vitit 2015 dhe do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raportim për njohuritë e përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin mediatik për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe do të shpallen rezultatet e dy hulumtimeve në terren të opinionit publik për perceptcionet e qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdimësi i projektit “Kuvendi nën thjerrëz përforcimi i debatit politik dhe diskursi deliberativ” i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – IIDHR dhe u realizua në periudhën nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.



Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

dhjetor 2015 – prill 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје